

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 8190
E martë, 25 nëntor 2025
Çmimi 0.50 €

Përplasjet politike
lënë Prishtinën pa
transport publik, FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com




facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

DY RRËFIME, NJË VENDIM: SI DO TË MBAHET MEND UÇK-ja?



Gjyqi i katër ish-krerëve të UÇK-së në Hagë po i afrohet fundit, duke mbyllur një maratonë dyvjeçare dëshmish. Prokuroria dhe mbrojtja kanë ofruar dy narrative të kundërt: një UÇK të strukturuar me zinxhir komandues deri te Thaçi dhe një forcë guerile pa hierarki të qartë. Ekspertët presin që aktgjykimi të shpallet në pranverë ose në fillim të verës, ndërsa faktorë vendimtarë do të jenë disa - nga sjellja e dëshmitarëve deri te koherenca e rrëfimeve

**AVOKATI PROSPER:
NËSE GJYQARËT
E SHOHIN TË
VËRTETËN, THAÇI
DHE TË TJERËT DO
TË JENË TË LIRË** F. 3



**OSMANI DHE KURTI
BISEDOJNË ME
KONGRESISTËT
AMERIKANË PËR
BASHKËPUNIMIN
ME SHBA-në** F. 7



OPINION

**KOSOVA... PARA VDEKJES
KLINIKE!** F. 8

Behxhet Sh. S
HALA - BAJGORA



**SPECIALJA, TEPËR SPECIALE
E HAGËS** F. 7

Lulëzim ETEMAJ



AKTUALE



**KOSOVA NË KONFERENCËN
MINISTRORE TË FRANKOFONISË,
NË KIGALI TË RUANDËS** F. 6

EKONOMI



**KEDS-i THEKSON GATISHMËRINË
PËR TË KONTRIBUAR
NË PROJEKTET HULUMTUESE
TË RRJETIT DISTRIBUTIV** F. 8

SPORT

**KOSOVA IA NDIEN ERËN KUALIFIKIMIT
NË KUPËN E BOTËS 2026 NJË
DEKADË PAS PRANIMIT NË FIFA** F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVIÇË
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

SHBA-JA THOTË SE PROPOZIMI PËR PAQE ËSHTË “PËRDITËSUAR” PËR TA MBROJTUR PLOTËSISHT UKRAINËN

WASHINGTON, 24 NËNTOR - Shtëpia e Bardhë ka thënë se bisedimet në Gjenevë me Kievin shënuan “përparim domethënës” drejt përfundimit të luftës në Ukrainë dhe kanë rezultuar me një kornizë “të përditësuar dhe ridefinuar” që parasheh sovranitetin e plotë të Ukrainës dhe arritjen e paqes. Në deklaratën e 23 nëntorit të lëshuar nga Uashingtoni nuk janë përmendur specifika të ndryshimeve që janë bërë në planin e paqes prej 28 pikash që është çuar përpara nga presidenti amerikan Donald Trump dhe i cili është kritikuar nga mbështetësit e Kievit, të cilët e kanë konsideruar dokumentin shumë miqësor për Rusinë. Propozimi amerikan raportohej se përfshinte edhe zvogëlimin e numrit të forcave të armatosura ukrainase, njëkohësisht zvogëlim të ndihmës ushtarake nga Shtetet e Bashkuara, e cila ka qenë thelbësore në luftën e Ukrainës kundër ushtrisë ruse. “Bisedimet kanë qenë konstruktive, të fokusuara, të zhvilluara me respekt dhe nënvizojnë përkushtimin e përbashkët për të arritur paqe afatgjatë”, është thënë në deklaratën e përbashkët të lëshuar nga Shtetet e Bashkuara dhe Ukraina. “Diskutimet shënojnë përparim domethënës drejt përafrimit të pozicioneve dhe identifikim të hapave të ardhshëm”. “Në bisedime është bërë e qartë se çdo marrëveshje e së ardhmes duhet të ruajë sovranitetin e Ukrainës dhe të përcaktojë vetëm paqe të qëndrueshme. Si rezultat i diskutimeve, palët e kanë përpiluar një kornizë të përditësuar dhe të ridefinuar”, është thënë në deklaratë, pa dhënë më shumë hollësi. Në deklaratë është përmendur

edhe që palët janë pajtuar “të jenë në kontakt të ngushtë me partnerët evropianë” të cilët mbesin disa prej mbështetësve me të fuqishëm të Ukrainës. Vetë Trumpi nuk ka bërë ndonjë koment publik pas takimit. Bashkë me disa aleatë evropianë të Ukrainës, disa ligjvënës amerikanë - përfshirë disa republikanë - e kanë kritikuar propozimin original, dhe disa e kanë përshkruar si shumë adekuat për Kremlinin. Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, e ka udhëhequr delegacionin amerikan në bisedimet e 23 nëntorit me zyrtarët ukrainas në Gjenevë, teksa Uashingtoni e ka rritur presionin ndaj Kievit për të pranuar shpejt planin amerikan. Trumpi është shprehur i zemëruar me Ukrainën dhe aleatët evropianë që e kanë kundërshtuar propozimin fillestar. Pas takimit, Rubio ka thënë se është arritur përparim i jashtëzakonshëm dhe që Trumpi është shumë i kënaqur. Menjëherë pas bisedimeve në Zvicër, Rubio është kthyer në Uashington. Shefi i delegacionit ukrainas Andriy Yermak - shefi i stafit të presidentit Volodymyr Zelensky - u ka thënë gazetarëve se negociatat kanë shënuar përparim në Gjenevë, dhe që po shkohet përpara drejt arritjes së paqes afatgjatë të cilën populli ukrainas e meriton. Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt të vitit 2022. Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën “operacion special ushtarak” për të çmilitarizuar Ukrainën. Përndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të



ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Takim Zelensky - Trump?

Disa agjenci perëndimore të lajmeve kanë cituar burime të tyre të kenë thënë se zyrtarë amerikanë dhe ukrainas kanë diskutuar edhe një vizitë potenciale të Zelenskyt në Uashington - diku rreth javës tjetër - për të diskutuar më në hollësi me Trumpin. Agjencia “Reuters” e ka cituar një burim të ketë thënë se bisedimet do të fokusohen në njërën prej çështjeve më sensitive të planit 28-pikësh - siç është ajo e mundësisë së koncesioneve territoriale ukrainase për Rusinë. Plani original nuk është shpalosur publikisht, mirëpo ka rrjedhur nga disa agjenci të lajmeve. Mes të tjerash, në plan përmendet që Ukraina të heqë dorë nga rajonet Donjeck dhe Luhansk - që njihen si Donbas - si dhe nga Krimeja. Kievit do t'i kërkohej edhe që ta përfshinte në Kushtetutë se nuk do të anëtarësohej në NATO. Sipas

planit, Moskës do t'i hiqeshin disa sanksione financiare. Në kthim, Ukraina do të pranonte një formë të “garancive të sigurisë”, sidomos nga Shtetet e Bashkuara, do t'i lejohej anëtarësimi në Bashkimin Evropian dhe do të pranonte disa përfitime financiare. Rusisë do t'i kërkohej të tërhiqej nga disa rajone ukrainase që tashmë i ka pushtuar.

Hollësitë e planit evropian

Agjencia gjermane e lajmeve dpa ka thënë se një plan alternativ evropian nuk do t'i kërkonte Ukrainës që të hiqte dorë nga territori që ende e kontrollon dhe do të parashihte numër më të madh të pjesëtarëve në ushtrinë ukrainase - 800 mijë në vend të 600 mijë sa përmendet në propozimin amerikan. Edhe ai plan parasheh garanci të forta të sigurisë për Ukrainën. Në atë plan nuk përjashtohet krejtësisht anëtarësimi i Ukrainës në NATO dhe Rusisë nuk do t'i garantohej amnisti e plotë për krimet e luftës, sipas raportimeve të dpa-së, pa cituar burime. Liderët evropianë dhe afrikanë po takohen më 24 nëntor në Angola

për një samit ekonomik dhe pritet që lufta e Rusisë në Ukrainë të jetë temë urgjente e diskutimit mes liderëve evropianë. Kremlini nuk i ka komentuar bisedimet në Gjenevë, ndonëse presidenti turk, Recep Tayyip Erdogan ka thënë se do ta zhvillojë një bisedë telefonike me homologun e tij rus, Vladimir Putin më 24 nëntor për t'i diskutuar përpjekjet për paqe në Ukrainë.

Viktima të shumëfishta në Harkiv

Teksa zhvilloheshin bisedimet në Gjenevë, vrasjet vazhdonin të raportoheshin në luftën që po hyn në vitin e katërt. Zyrtarët ukrainas kanë thënë se Rusia ka nisur sulm masiv me dronë në Harkiv më 23 nëntor, duke vrarë të paktën katër njerëz dhe duke plagosur 17 të tjerë në një zonë banimi. Rusia vazhdon të kryejë thujtase çdo natë sulme me dronë dhe raketa në objekte banimi, si dhe në qendra komerciale e objekte tjera infrastrukturore. Kremlini, në anën tjetër, e mohon se shënjestron zona të civilëve, pavarësisht sulmeve të vazhdueshme në ato pjesë. Sulmet ruse në infrastrukturën e energjisë i kanë lënë miliona njerëz pa ngrohje apo rrymë për disa orë gjatë ditës. Ndërkohë, një ofensivë tokësore në lindje të Ukrainës e ka rritur presionin ndaj Kievit, teksa synon t'i negociojë kushtet për paqe. Ukraina është përgjigjur duke nisur dronë në objektet ruse të energjisë apo qendra tjera që, sipas Kievit, Moska i përdor për t'i nisur sulmet në tokën ukrainase. Rusia, gjithashtu, është përballur me probleme me rrymë dhe ekonomia e saj është dërmuar nga sanksionet.

Izraeli shkarkon disa gjeneralë për shkak të sulmit të 7 tetorit

JERUSALEM, 24 NËNTOR - Ushtria izraelite njoftoi se ka shkarkuar tre gjeneralë dhe ka ndërmarrë masa disiplinore ndaj disa zyrtarëve të tjerë të lartë lidhur me dështimin e tyre për të parandaluar sulmin e tetorit të vitit 2023 nga Hamasi - grupi palestinez i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - që është sulmi më vdekjeprurës në historinë e vendit. Njoftimi vjen dy javë pasi shefi i ushtrisë izraelite, Eyal Zamir, bëri thirrje për një “hetim sistematik” lidhur me

dështimet që çuan te sulmi, edhe pse Qeveria ende nuk e ka themeluar një komision shtetëror hetimor pavarësisht presionit publik. Lista e gjeneralëve të shkarkuar përfshin tre komandantë divizionesh, njëri nga të cilët ka shërbyer si shef i inteligjencës ushtarake. Në deklaratën e ushtrisë izraelite u tha se të tre mbajnë përgjegjësi personale për dështimin e forcave të armatosura për të parandaluar sulmin e nisur nga Hamasi. Shkarkimet vijnë pasi të tre gjeneralët veçse kishin dhënë

dorëheqje nga postet e tyre, përfshirë kreun e komandës jugore, gjeneralin Yaron Finkelman. Ndërkaq, masa disiplinore u tha se janë ndërmarrë ndaj kreut të marinës dhe forcave ajrore si dhe ndaj katër gjeneralëve dhe disa zyrtarëve të lartë. Kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu, vazhdimisht ka përsëritur se dështimet që çuan deri te sulmi i 7 tetorit duhet të adresohen pasi lufta në Gazë të përfundojë. Qeveria e tij deri më tani nuk e ka formuar një komision hetimor, i cili do të



përcaktonte se kush mban përgjegjësinë për mosparandalimin e sulmit. Gjatë sulmit, Hamasi vrau afër 1.200 persona dhe rrëmbeu 251 të tjerë, duke nxitur luftën në Gazë.

Si pasojë e sulmeve hakmarrëse të Izraelit, në Gazë u vranë më shumë se 69 mijë persona, sipas të dhënave të Ministrisë së Shëndetësisë në Gazë - shifra që Kombet e Bashkuara i konsiderojnë të besueshme

AVOKATI PROSPER: NËSE GJYQTARËT E SHOHIN TË VËRTETËN, THAÇI DHE TË TJERËT DO TË JENË TË LIRË

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Avokati i ekipit mbrojtës të ish-presidentit Hashim Thaçi, Pierre Richard Prosper, ka thënë se për pesë vjet kanë qenë duke u fshehur pas një reje keqinterpretimesh dhe të ndryshimit të historisë. Por tani, që ka përfunduar procesi i dëgjimit të dëshmitarëve mbrojtës, ai tha se bota ka pasur mundësi të shohë cili është realiteti. Këto komente Prosper i ka bërë në një intervistë në emisionin “Info Magazine” në “Klan Kosova”. Ai shpreh mendimin se është arritur të nxirret në pah e vërteta gjatë këtij procesi dhe, për pasojë, Thaçi dhe të tjerët do të jenë të lirë. “Kemi besim se gjyqtarët tani do t’i shohin informacionet dhe provat për ta kuptuar saktësisht se çfarë ka ndodhur dhe si ka qenë situata. Por, në fund të ditës, kemi triumfuar duke regjistruar të dhëna të sakta historike. Tani u mbetet në dorë gjyqtarëve, mirëpo mendoj se nëse e shohin të vërtetën ashtu siç është, presidenti Thaçi dhe të tjerët do të jenë burra të lirë”, u shpreh ai në këtë intervistë. Ai tha se ndihet i shqetësuar nga ajo që ka parë, me kualitetin e provave mbi të cilat mbështetet Prokuroria për ta dënuar dikë. “Nuk mendoj se ky është standardi që duhet të merret shembull nga kushdo, qoftë gjykatë vendore apo ndërkombëtare. Nuk mund të jemi në një situatë ku Prokuroria mbështetet në deklarata e raportime shtypi, libra, madje nuk e prezanton as autorin e librit. Prokuroria mbështetet edhe në drafte librash, ja këto i ka prova!”, deklaroi ai. Sipas Prosperit, një proces gjyqësor duhet të jetë vendi ku dikush i cili ka vuajtur duhet të vijë dhe të tregojë se çfarë i ka ndodhur dhe ku pala tjetër e



ka mundësinë ta ekzaminojë, “por të mbështetesh në citime të BBC-së a CNN a AP-së si ajo të jetë prova dhe e vërteta, është shokuese!”. “Ne me këso procedura kemi punë dhe me to do të merremi, por mendoj se jo vetëm në shtetet në zhvillim e sipër, por edhe në vendet e zhvilluara, nuk veprohet kështu. Dhe mendoj se sistemi gjyqësor ndërkombëtar e ka humbur rrugën”, potencoi Pierre Richard Prosper. Ai nuk dëshoi të komentojë nëse Gjykata në Hagë është politike. “Duhet ta lëmë procesin të përfundojë. Ata janë gjyqtarë me përvojë, të edukuar dhe intelektualë, duhet të mbështetemi tek ta dhe të kemi besim se ata e

kanë parë të vërtetën! Kur ta marrin vendimin, nëse do të jetë i atillë me të cilin ne nuk pajtohemi, në atë pikë do të jem në gjendje të ta jap mendimin tim për natyrën apo cilësinë e vendimit të tyre”, tha ai, duke shtuar se: “Shpresoj se kur të arrijmë në atë pikë do ta shohim të vërtetën, dhe e vërteta duhet të pasojë me lirinë e atyre personave”. Avokati i ish-presidentit të Kosovës, Pierre Richard Prosper, tha se nëse Thaçi dhe të tjerët shpallen fajtorë, është vlerësim i padrejtë i tërë historisë. “Mendoj se nëse ata shpallen fajtorë, mendoj se është një keqkuptim i qartë dhe vlerësim i padrejtë jo vetëm për të vërtetën, por për gjithë historinë. Mendoj se jo

vetëm historia por të dhënat historike brenda NATO-s dhe kujtimet e zyrtarëve përgjatë zinxhirit komandues si dhe të dhënat historike të të gjitha qeverive janë krejt të kundërta me një përfundim të tillë”, deklaroi Prosper në “Klan Kosova”. Sipas tij, të gjithë dëshmitarët e mbrojtjes u larguan të hutuar duke pyetur “pse jemi këtu?” dhe nëse ktheheni mbrapa te komentet dhe përshtypjet që kanë dhënë vite më parë, mbetet kjo, “pse jemi këtu”. “Kjo pyetje vlen për të gjithë dëshmitarët. Kjo nuk ka kuptim. ‘Pse jemi këtu?’. Akoma nuk e dimë. Sepse përgjigja te e cila arrijmë është ajo se ne nuk duhet të jemi këtu. Edhe presidenti Thaçi,

personi për të cilin jam i autorizuar të flas në emër të tij, nuk duhet të jetë këtu, sepse nuk është përgjegjës për ato pretendime e abuzime për të cilat flet prokuroria. S’mund të jetë më e qartë”, u shpreh avokati i Thaçit.

Ai është i mendimit se pas dëgjimit të dëshmitarëve mbrojtës, Thaçi dhe të tjerët janë të mendimit se tashtë e vërteta është nxjerrë në pah. “Përfundimi megjithatë nuk është në dorën e tyre, as në dorën time, por në dorë të gjyqtarëve. Sidoqoftë të ulesh aty për z. Thaçi dhe të tjerët, dhe mundësia për të dëgjuar gjithë këto figura të mirënjohura dhe të zgjuara që tregojnë se si kanë qenë ngjarjet dhe t’i tregojnë gjykatës të vërtetën, mendoj se pas kësaj thjesht e lë në duar të fatit, sepse ata e dinë se historia do ta dëshmojë të vërtetën, cilido që të jetë përfundimi i këtij gjykimi”, theksoi Prosper, duke shtuar se gjatë dhe pas luftës në Kosovë, ish-presidenti Hashim Thaçi nuk ka pasur komandë dhe kontroll mbi pjesëtarët individual të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ai shtoi se Prokuroria e Specializuar e ka trajtuar çështjen asisoj që për secilin abuzim që ka ndodhur, Thaçi dhe të tjerët janë përgjegjës, “kjo për shkak të natyrës së titujve apo pozicioneve që kanë pasur”. “Kjo nuk është e vërteta. Janë gjithë këta dëshmitarë që erdhën dhe dëshmuan se nuk ka pasur sistem të organizuar të komandës dhe kontrollit brenda Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe kur e shohim këtë, mund të vijmë në përfundim se ata nuk mund të mbahen përgjegjës për veprimet e individëve përgjatë asaj kohe”, deklaroi avokati Prosper.

SPECIALJA, TEPËR SPECIALE E HAGËS

Lulëzim ETEMAJ

Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë na e dëshmojnë edhe një herë se s’kanë asnjë lidhje me Kosovën. Ato kanë caktuar mbajtjen e një konference përgatitore ndaj ish-presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, pikërisht më 28 Nëntor - ditën më të shenjtë të historisë, identitetit dhe krenarisë sonë kombëtare. 28 Nëntori nuk është një datë e zakonshme në kalendarin tonë historik kombëtar. Është dita kur Gjergj Kastrioti-Skënderbeu ngriti flamurin në Krujë, duke shënuar ringritjen e

dinjitetit shqiptar; është dita e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë; është ditëlindja e komandantit legjendar Adem Jashari dhe, njëkohësisht, dita e daljes publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), forcës që mishëroi aspiratat e çlirimit dhe lirisë së popullit tonë. Për këtë arsye, caktimi i një seance gjyqësore në këtë datë të shenjtë për ne paraqet një mungesë të thellë ndjeshmërie, respekti dhe kuptimi për historinë, sakrificat dhe simbolikën tonë kombëtare. Ky veprim e forcon bindjen se Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar, në vend që të jenë

institucione të drejtësisë, po shfaqen si struktura të shkëputura nga realiteti i Kosovës dhe, siç shihen nga shumë, si institucione me karakter të përndjekjes politike. Çdo proces gjyqësor duhet të zhvillohet mbi parime të drejtësisë, paanshmërisë dhe respektit. Vendimmarrja për mbajtjen e kësaj seance në datën më domethënëse të kombit shqiptar dërgon një mesazh krejt të kundërt. Siç po duket, është e tepërt të pritët nga Specialja e Hagës respekt për ndjenjat tona kombëtare dhe trajtim dinjitoz të krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.





DY RRËFIME, NJË VENDIM: SI DO TË MBAHET MEND UÇK-ja?

Gjyqi i katër ish-krerëve të UÇK-së në Hagë po i afrohet fundit, duke mbyllur një maratonë dyvjeçare dëshmish. Prokuroria dhe mbrojtja kanë ofruar dy narrativë të kundërt: një UÇK të strukturuar me zinxhir komandues deri te Thaçi dhe një forcë guerile pa hierarki të qartë. Ekspertët presin që aktgjykimi të shpallet në pranverë ose në fillim të verës, ndërsa faktorë vendimtarë do të jenë disa - nga sjellja e dëshmitarëve deri te koherenca e rrëfimeve

PRISHTINE, 24 NËNTOR - Dy vjet dëshmi, qindra dëshmitarë dhe një gjykatë që do të vendosë se si do të mbahen mend Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe udhëheqësit e saj: Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi e Rexhep Selimi. Katërshja, në paraburgim që nga viti 2020, pret verdiktin në Hagë, ndërsa dy vjetët e fundit të dëshmimeve hodhën dritë mbi rolet dhe përgjegjësinë e saj gjatë dhe pas luftës në Kosovë. Ushtria Çlirimtare e Kosovës u formua në fillim të '90-ave si një grup gueril që luftonte për të drejtat e shqiptarëve nën regjimin serb të kohës. Gjatë luftës së viteve 1998-1999, ajo u shndërrua në forcën kryesore të rezistencës së armatosur. Udhëheqësit e saj politikë, përfshirë Hashim Thaçin, dolën në skenën ndërkombëtare në fillim të vitit 1999, kur morën pjesë në negociatat e Rambujesë. Aty UÇK-ja u legjitimua si palë negociuese në procesin që synonte t'i jepte

fund luftës dhe të hapte rrugën drejt një zgjidhjeje politike për Kosovën. Kur vendi shpalli pavarësinë më 2008, Thaçi ishte kryeministër. Tetë vjet më vonë u zgjodh president dhe shërbeu deri më 2020, kur dha dorëheqje për t'u përballur me akuzat e Gjykatës Speciale në Hagë. "Nuk do të lejoj në asnjë rrethanë që para gjyqit të dalë presidenti i Republikës së Kosovës. Prandaj, për të mbrojtur integritetin e Presidencës së Republikës së Kosovës, integritetin e shtetit të Kosovës, integritetin dhe dinjitetin e qytetarit të Kosovës, popullit të Kosovës, duke respektuar edhe partneritetin me bashkësinë ndërkombëtare, unë sot jap dorëheqje nga pozita e presidentit të Republikës së Kosovës", tha Thaçi më 5 nëntor, 2020. Përveç Thaçit, në Gjykatë u dorëzuan edhe Kadri Veseli, i cili ishte udhëheqës i shërbimit të inteligjencës në UÇK, Jakup Krasniqi - zëdhënës, dhe

Rexhep Selimi nga shtabi i përgjithshëm. Aktakuza kundër tyre, e konfirmuar më 26 tetor 2020 dhe e publikuar më 5 nëntor të atij viti, e ngarkon secilin me akuza për krime kundër njerëzimit dhe për krime lufte, të kryera nga marsi i vitit 1998 deri në shtator, 1999, në Kosovë dhe në veri të Shqipërisë. Sipas aktakuzës, katër burrat ishin pjesë e një "ndërmarrjeje të përbashkët kriminale" dhe "ndanin qëllimin e përbashkët për të fituar dhe ushtruar kontroll mbi të gjithë Kosovën me anë të mjeteve që përfshinin frikësimin, keqtrajtimin, kryerjen e dhunës dhe largimin e paligjshëm të atyre që konsideroheshin kundërshtarë". Këta "kundërshtarë" dyshohet se përfshinin pakica etnike - serbë, romë dhe të tjerë - si dhe shqiptarë që nuk e mbështesnin UÇK-në. Së paku 102 persona dyshohet se u vranë dhe më shumë se 20 të tjerë konsiderohen të zhdukur. Aktakuza, gjithashtu, i referohet përgjegjësisë superiore të të pandehurve, për shkak të pozitave të larta udhëheqëse brenda UÇK-së, për krimet e kryera nga personat nën kontrollin e tyre dhe anëtarët e "ndërmarrjes së përbashkët kriminale". Katërshja mohoi fajësinë, ndërsa gjykimi nisi më 3 prill të vitit 2023. Në fjalimin e tij hapës në gjyq, prokurori i specializuar në detyrë, Alex Whiting, tha se

"shumica e viktimave të të pandehurve ishin bashkëkombës shqiptarë të Kosovës". "Në zellin e tyre për të goditur dhe eliminuar ata që i konsideronin kundërshtarë, të pandehurit mbështetën dhe zbatuan një politikë që shpesh i viktimizonte edhe të vetët e tyre", tha Whiting. Gjatë këtyre dy vjetëve, prokuroria prezantoi qindra dëshmi: 117 me shkrim dhe 125 dëshmitarë që dëshmuan në sallën e gjyqit. "Prej se ka ardhur, në '98-ën, i kam parë me sytë e mi punët e tij [Thaçit]... Ka menduar të na shfarosë... Ka menduar të na shfarosë... Nuk kemi kohë, sepse kemi shembuj tjerë të tregojmë... Kam shumë shembuj tjerë. Kjo është e vërteta... me krejt familjen, qëllimi i tij ka qenë të na shfarosë", tha Fadil Geci, dëshmitar i prokurorisë, në tetor të vitit 2024. Mbrojtja e Thaçit nisi paraqitjen e provave më 15 shtator të këtij viti. Ekipi i Krasniqit paralajmëroi dy dëshmitarë në sallë dhe dy dëshmi me shkrim, ndërsa mbrojtjet e Veselit dhe Selimit nuk paraqitën prova. Dëshmitarët e mbrojtjes - kryesisht zyrtarë të lartë perëndimorë me njohuri të drejtpërdrejtë të ngjarjeve - filluan me James Rubinin, ish-ndihmës sekretar i Shtetit amerikan. Strategji e mbrojtjes ishte të argumentonte se UÇK-ja nuk kishte një strukturë të qartë komanduese dhe se Thaçi,

shpesh jashtë Kosovës dhe në rol politik, nuk ushtronte autoritet mbi operacionet. Rubin dëshmoi për tri ditë radhazi, ndërsa në sallë ishin të pranishëm si vëzhgues edhe zyrtarë aktualë të Departamentit amerikan të Shtetit. Rubin dëshmoi se Thaçi "kishte eprorë nga të cilët duhej të merrte miratim" dhe se ai ishte "më shumë një fytyrë publike për t'u prezantuar në Perëndim". "Hashim Thaçi duhej t'u drejtohej këtyre komandantëve të [UÇK-së] për informacion, njohuri, vendime... Kështu që, unë e kam parë duke treguar respekt ndaj tyre për çështjet përmbajtësore të UÇK-së", tha Rubin. Dëshmia e tij u mbështet nga një sërë personalitetesh që e pasuan atë në bankën e dëshmitarëve - nga Paul Williams, ish-këshilltar ligjor i Kosovës, deri te Wesley Clark, gjenerali që udhëhoqi fushatën ajrore të NATO-s kundër cageve të atëhershme jugosllave në vitin 1999. "Më kujtohet që e kam parë Thaçin, sepse ka qenë zëdhënës. Ishte i pastër, i veshur mirë, dukej më perëndimor se të tjerët. Nuk dukej se kishte qenë në mal, duke luftuar për një ose dy vjet rresht. Ishte e qartë se ai nuk ishte përgjegjës", dëshmoi Clark. Clark ishte dëshmitari i fundit i mbrojtjes, duke e përmbyllur dëshminë e tij më 18 nëntor. Një ditë më vonë, gjatë konferencës

mbi ecurinë e çështjes, avokati i Thaçit, Lluka Mishiçi, sinjalizoi se mbrojtja mund të kërkojë edhe një dëshmitar shtesë.

Megjithatë, mbrojtja dhe prokuroria ranë dakord që dosjet përfundimtare të dorëzohen deri më 30 janar të vitit të ardhshëm, apo 60 ditë pas përfundimit të paraqitjes së provave. Me këtë rast, po ashtu, u tha se deklaratat përmbyllëse nga ana e prokurorisë, mbrojtjes dhe përfaqësuesve të viktimave do të jepen pas dorëzimit të dosjeve finale.

Zëdhënësi i Speciales, Michael Doyle, i tha Radios Evropa e Lirë se “rregullat parashohin që gjyqtarët duhet ta shpallin aktgjykimin brenda 90 ditësh nga mbyllja e çështjes - përveç në rastet kur rrethanat kërkojnë më shumë kohë”.

Njohësi i çështjeve ligjore, Mark Ellis, pret që gjykimi të shpallet në pranverë ose fillim të verës. Ai vlerëson se çështja është në një pikë realisht të

balancuar: provat aktuale lejojnë si mundësinë e dënimit, ashtu edhe të pafajësisë. Gjithçka do të varet nga mënyra se si gjykatësit do ta interpretojnë strukturën komanduese të UÇK-së, sipas tij. “Çdo dëshmi vlerësohet më vete, në bazë të besueshmërinë, saktësisë, qëndrueshmërisë, dhe jo në bazë të asaj se cila palë e ka thirrur dëshmitarin. Gjykatësit marrin parasysh faktorë të tillë si: sjellja e dëshmitarit, koherenca e rrëfimit, interesat apo paragjykimet e mundshme, si dhe mënyra se si dëshmia qëndron gjatë ballafaqimit në sallë”, shpjegon Ellis, drejtor i Odës Ndërkombëtare të Avokatëve, për programin Expose të Radios Evropa e Lirë.

Në këtë gjykim, prokuroria dhe mbrojtja ofruan dy rrëfime krejt të kundërta për UÇK-në: e para e paraqiti si organizatë të strukturuar me zinxhir komandimi

deri te Thaçi, ndërsa tjetra si një grup gueril pa hierarki formale. Ellis thotë se, në raste si këto, gjyqtarët duhet të vlerësojnë besueshmërinë e çdo versionit, sepse shpesh të dyja palët mund të kenë elemente të së vërtetës. Ai shton se standardet ligjore janë gjithashtu vendimtare në këtë proces. “Për shembull, ligji ndërkombëtar mbi përgjegjësinë komanduese dhe ‘ndërmarrjen e përbashkët kriminale’ nuk kërkon domosdoshmërisht një hierarki të zakonshme ushtarake; mjafton kontrolli efektiv ose një organizim funksional për të zbatuar një plan të përbashkët. Gjyqtarët do të shqyrtojnë nëse Thaçi dhe të tjerët kishin kontroll efektiv mbi ata që kryen abuzime”, thotë Ellis.

Dhe, provimi i ekzistencës së një hierarkie - formale ose faktike - si dhe përcaktimi i rolit të secilit të pandehur brenda saj do të janë vendimtare për ngritjen e përgjegjësisë penale, përfundon Ellis.

Ky gjyq është më i rëndësishmi deri më tani për Gjykatën Speciale, e cila është pjesë e një përpjekjeje ndërkombëtare për të hetuar konfliktet e brendshme në Kosovë, gjatë dhe pas luftës për pavarësi, në fund të viteve '90.

Cilido që të jetë vendimi, ai pritet të ketë jehonë edhe përtej Kosovës - mbase deri në SHBA, sepse, siç ka theksuar edhe Rubin në dëshminë e tij, Thaçi, me vite të tëra, ka bashkëpunuar ngushtë me Uashingtonin për paqe dhe pavarësi.

Joe Biden, si zëvendëspresident i SHBA-së, e quajti atë “George Washingtoni i Kosovës” kur vizitoi Shtëpinë e Bardhë në vitin 2010.

Richard Grenell, i cili ishte i dërguari special për negociatat e normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë gjatë administratës së parë të presidentit Donald Trump, e cilësoi ndalimin e Thaçit si një “padrejtësi të rëndë”.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës, edhe pse e shpërbërë, mbetet një organizatë popullore për shumë kosovarë, të cilët ia atribuojnë asaj luftën që çoi në pavarësi. Ndaj, shumë qytetarë besojnë se Gjykata Speciale në Hagë është e njëanshme ndaj UÇK-së dhe synon të diskreditojë rolin e saj. Kjo ka nxitur disa protesta jo vetëm në Prishtinë, por edhe në Tiranë, Hagë dhe qytete të tjera.

Specialja, e njohur zyrtarisht si Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar, funksionon si pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, por përbëhet nga gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtarë. Sa i përket stafit, amerikanët janë grupi i dytë më i madh pas holandezëve.

Vendimi i tyre do të përcaktojë jo vetëm përgjegjësinë e të pandehurve, por edhe mënyrën se si Kosova e sheh dhe e rrëfen një pjesë të ndjeshme të historisë së saj të fundit.



PËRPLASJET POLITIKE LËNË PRISHTINËN PA TRANSPORT PUBLIK

Prishtinë, 24 nëntor - Banorët e kryeqytetit të Kosovës, Prishtinës, janë detyruar që të hënën të bëjnë zgjidhje alternative në mungesë të transportit publik. Qeveria në detyrë dhe zyrtarët komunalë vazhdojnë të mos i kursejnë që disa muaj akuzat ndaj njëritjetrit për situatën e komplikuar me financat në komunë. Por, një gjë dihet: komuna e Prishtinës e ka miratuar me vonesë buxhetin për vitin 2025 dhe, rrjedhimisht, Ministria e Financave e ka hartuar një version të buxhetit për të.

Operatorët privatë dhe ata të ndërmarrjes së “Trafikut Urban”

kanë protestuar të hënën para objektit të Qeverisë së Kosovës, duke kërkuar zgjidhje për problemet e vazhdueshme me pagesat dhe subvencionet për transportin urban.

Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, i cili ishte pjesë e kësaj proteste, u ka bërë thirrje për takim Kurtit dhe Muratit për të bërë zgjidhje për punëtorët për pagat e tyre. “Albin, Hekuran, mos rrini në zyra e në xhipe. Hajde takohemi dhe e bëjmë zgjidhjen për punëtorët dhe qytetarët e Prishtinës! Sot iu bashkova protestës sepse jam dhe do të jem gjithmonë me punëtorët

dhe qytetarët e kryeqytetit. Prej një viti kërkojmë zhblokimin e buxhetit, ndërsa ai vazhdon të mbahet padrejtësisht peng për interesa politike. Jam me ju punëtorë dhe do të qëndroj në krahun tuaj deri në zgjidhjen e këtij problemi dhe kthimin e shërbimeve që qytetarët meritojnë!”, ka thënë Rama. Ai ka theksuar se punëtorët po i presin pagat që u takojnë. “Qytetarët po i presin shërbimet që u takojnë. Kryeqyteti po e pret buxhetin që i takon! Mos bëni politikë me nevojat bazike të qytetarëve. Është e pandershme dhe jonjerëzore”, ka deklaruar Rama.



Certifikohen 45 kandidatë të rinj si përkthyes dhe interpretë gjyqësorë

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ka organizuar ceremoninë e radhës për shpërndarjen e certifikatave për përkthyesit dhe/ose përkthyesit dhe interpretët gjyqësorë të certifikuar. Kryesuesi i KGJK-së, Albert Zogaj, duke e vlerësuar këtë proces si shumë të rëndësishëm për sistemin gjyqësor, falënderoi anëtarët e komisioneve vlerësuese si dhe

monitoruesit ndërkombëtarë për pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre me qëllim që procesi të jetë profesional dhe transparent. Kryetari i Komisionit për Administrimin e Gjykatave, Fahret Vellija, ka theksuar se certifikimi i përkthyesve dëshmon angazhimin dhe besueshmërinë e tyre në sigurimin e drejtësisë për të gjithë si dhe garanton cilësinë e shërbimeve në sistemin gjyqësor në gjuhë të ndryshme. Gjithsej 45 kandidatë të rinj janë certifikuar dhe emëruar nga

KGJK, prej tyre 39 janë certifikuar si përkthyes gjyqësorë, ndërsa 6 si përkthyes dhe interpretë gjyqësorë, për këto gjashtë çifte gjuhësh: Shqip - turqisht dhe anasjelltas; Shqip - gjermanisht dhe anasjelltas; Shqip - frëngjisht dhe anasjelltas; Shqip - arabisht dhe anasjelltas; Shqip - italisht dhe anasjelltas dhe shqip - spanjisht dhe anasjelltas. Ky proces është monitoruar nga partnerë ndërkombëtarë, përfshirë Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).



KOSOVA NË KONFERENCËN MINISTRORE TË FRANKOFONISË, NË KIGALI TË RUANDËS

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Kosova mori pjesë në sesionin e 46 të Konferencës Ministrore të Frankofonisë (CMF) që u mbajt në Kigali të Ruandës më 19 dhe 20 nëntor. Në krye të delegacionit të Kosovës ishte Bardhyl Dobra, zëvendësministër i Punëve të Brendshme, kurse anëtarë të delegacionit ishin Shemsi Krasniqi, përfaqësues personal i presidentes së Kosovës në Frankofoni dhe Arbër Maliqi, sekretar i dytë i Ambasadës së Kosovës në Paris. Tema e konferencës ishte “30 vjet pas Pekinit. Kontributi i grave në hapësirën frankofone”. Në fjalën e tij me këtë rast, Dobra theksoi se gratë e Kosovës kanë dhënë kontribut

të çmuar në lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, ndërsa ato sot po e bëjnë të mundur forcimin e demokracisë dhe shtetit tonë të pavarur. Zëvendësministri Dobra shprehu besimin se Kosova do të avancojë së shpejti statusin e saj në këtë organizatë, nga anëtar i asociuar në anëtar me të drejta të plota. Ai, po ashtu, kërkoi që të gjitha ato shtete anëtare të Frankofonisë që nuk e kanë njohur ende Republikën e Kosovës, ta bëjnë atë sa më parë, sepse vlerat e Frankofonisë dhe demokracisë janë ato që na bashkojnë, kurse njohja kontribuon në forcimin e mëtejshëm të këtyre vlerave. Delegacioni i Kosovës pati rastin të takohet dhe bisedojë me



përfaqësuese shtetesh dhe qeverish anëtare të Frankofonisë, si dhe me sekretaren e përgjithshme të

kësaj organizate, Louise Mushikiwabo. Po në Kigali, një ditë para Konferencës Ministrore, u mbajt

sesioni i 132-të i Këshillit të Përhershëm të Frankofonisë (CPF) ku morën pjesë Shemsi Krasniqi dhe Arbër Maliqi. Kosova ka qenë pjesë e grupit punues për hartimin e “Thirrjes së Kigalit”, dokument ky që bën thirrje për barazinë mes grave dhe burrave në hapësirën frankofone dhe që u aprovua nga ministrat e shteteve dhe qeverive frankofone në kuadër të kësaj konference ministrore. Delegacioni i Kosovës vizitën e vet në Ruandë e përmbylli me homazhet në Memorialin e Gjenocidit në Kigali, ku në emër të Republikës së Kosovës vendosi kurorë me lule, kurse zëvendësministri Dobra u nënshkrua në Librin përkujtimor.

MBAHET PUNËTORI DYDITORE PËR HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

Prishtinë, 24 nëntor - Më 21-22 nëntor Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) - Ministria e Drejtësisë, me mbështetjen e projektit të UNDP-së “Voices of Justice” - ka realizuar punëtorinë dyditore për hartimin e Projektligjit të ri për Ndihmë Juridike Falas. Punëtorja u hap nga Anita Alaj-Kalanderi, kryesuese e grupit punues dhe sekretare e përgjithshme në Ministrinë e Drejtësisë, e cila theksoi rëndësinë e këtij procesi dhe nevojën për një kornizë moderne



ligjore. Fjalën e morën Faton Jashari, u. d. drejtor ekzekutiv i ANJF dhe

Ardian Latifaj, menaxher i projektit “Voices of Justice” - UNDP.

Diskutimet tematike dhe procesi i analizës së dokumenteve u udhëhoqën nga eksperti i angazhuar, prof. dr. Visar Morina. Punëtorja mblodhi së bashku anëtarët e grupit punues, ekspertë juridikë, përfaqësues institucionalë dhe të shoqërisë civile, të cilët kontribuan në trajtimin e sfidave të ligjit aktual dhe në formulimin e rekomandimeve për përmirësim. Diskutimet u fokusuan në sfidat në zbatimin e ligjit ekzistues, strukturën institucionale dhe harmonizimin me standardet evropiane, shqyrtimin e draft-koncept dokumentit, kriteret e përfitimit dhe identifikimin e

kategorive të cënueshme, modellet e financimit, sfidat buxhetore dhe hapat e mëtejshëm drejt finalizimit të projektligjit. Ky projektligj synon ta fuqizojë ANJF-në dhe mekanizmat institucionalë që garantojnë qasje të barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët, veçanërisht për grupet më të cënueshme. ANJF shpreh mirënjohje për kontributin e të gjithë pjesëmarrësve dhe partnerëve, veçanërisht Ministrisë së Drejtësisë dhe UNDP-së, për mbështetjen e vazhdueshme në përmirësimin e sistemit të ndihmës juridike në Republikën e Kosovës.

“Dita e Forcës”, kazermat e FSK-së do të jenë të hapura për qytetarët më 27 nëntor

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Kazermat e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) do të jenë të hapura për qytetarët me rastin e “Ditës së Forcës” që do të jetë më 27 nëntor. “Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) ju fton të merrni pjesë

në ‘Ditën e Hapur’, që do të mbahet me rastin e ‘Ditës së Forcës’, më 27 nëntor, nga ora 09:00 deri në ora 14:00. Në kazermën ‘Adem Jashari’ në Prishtinë nga ora 09:30 do të jenë të pranishëm udhëheqësit e lartë

shtetërorë, mysafirë e ambasadorë të vendeve mike. Të gjithë qytetarët janë të mirëseardhur të vizitojnë kazermat e Forcës së Sigurisë së Kosovës në: Prishtinë, Prizren, Pomezotin, Istog, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjilan.

Në të gjitha kazermat e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), qytetarët do të kenë mundësi të shohin kapacitetet ushtarake të cilat do të jenë të ekspozuara në këtë ditë feste”, ka njoftuar FSK-ja.



OSMANI DHE KURTI BISEDOJNË ME KONGRESISTËT AMERIKANË PËR BASHKËPUNIMIN ME SHBA-në

Kongresisti republikan Mike Turner dhe ai demokrat Donald Norcross kanë zhvilluar të hënën takime të ndara me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, dhe kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, me të cilët kanë biseduar për thellimin e bashkëpunimit mes dy vende në fusha të ndryshme

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Presidentja e Vjosa Osmani ka pritur në takim të hënën kongresistin Michael Turner (R-OH) si dhe kongresistin Donald Norcross (D-NJ), me të cilët ka diskutuar zhvillimet e fundit në vend dhe thellimin e bashkëpunimit bilateral në mes të Kosovës dhe ShBA-së.

Presidentja Osmani shprehu mirënjohje për bashkëpunimin e shkëlqyer me kongresistin Turner dhe ekipin e tij gjatë Sesionit të Asamblesë Parlamentare të NATO-s në Dayton, si dhe për mbështetjen bipartizane të ShBA-së ndaj Kosovës. Kjo mbështetje, theksoi ajo, ka qenë e pazëvendësueshme në periudhën që na solli lirinë, pavarësinë e pastaj shtetndërtimin e demokracisë. Asnjë nga këto të arritura, theksoi presidentja Osmani nuk do të ishin të mundura pa përkrahjen amerikane. Më tej, presidentja theksoi se Kosova mbetet vendi më pro-amerikan në botë, thellësisht i përkushtuar ndaj reformave,

bashkëpunimit rajonal dhe forcimit të partneritetit me ShBA-në. Ajo diskutoi edhe për bashkëpunimin me administratën e presidentit Trump në fusha të ndryshme të interesit të dyanshëm.

Presidentja Osmani ritheksoi se anëtarësimi i Kosovës në NATO është imperativ strategjik për stabilitetin e Ballkanit Perëndimor dhe për paqen në kontinentin evropian. Për më tepër, potencoi se ushtarët e FSK-së tashmë shërbejnë përkrah ushtarëve amerikanë në misione jashtë vendit duke kontribuar për paqen e stabilitetin global, njëkohësisht Kosova ka ndërmarrë hapa vendimtarë në fuqizimin e sektorit të mbrojtjes e sigurisë, duke shpenzuar tashmë 2 % të GDP-së në mbrojtje, me synim që kjo të dyfishohet brenda pak vitesh.

Sa i përket sigurisë së brendshme dhe kërcënimeve rajonale, Osmani nënvizoi punën profesionale të institucioneve tona të sigurisë, njëkohësisht rëndësinë e vazhdimtë të pranisë amerikane në kuadër të KFOR-it. Ajo theksoi se prania amerikane



mbetet garanci e rëndësishme e paqes dhe sigurisë për qytetarët e Kosovës dhe gjithë rajonin, duke shprehur falënderimin e popullit të Kosovës për këtë kontribut.

Presidentja Osmani ritheksoi se edhe pas më shumë se dy vjetësh, Serbia ende po i përkrah terroristët që kryen aktin e agresionit në Banjskë, sepse autorët, përfshirë Milan Radojqiçin, nuk i janë dorëzuar drejtësisë. Ajo theksoi se llogaridhënia, si për këtë akt agresioni, ashtu edhe për sulmin ndaj ushtarëve të KFOR-it e sulme të tjera, është thelbësore për stabilitetin rajonal dhe për parandalimin e akteve të ngjashme në të ardhmen.

Edhe kryeministri në detyrë, Albin Kurti, i shoqëruar nga zëvendësministria në detyrë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Liza Gashi, ka mirëpritur të hënën një delegacion të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të përbërë nga kongresisti republikan Mike Turner dhe kongresisti demokrat Donald Norcross.

Të dy kongresistët janë pjesë e Asamblesë Parlamentare të NATO-s dhe të Komitetit të Shërbimeve të Armatosura të Dhomës së Përfaqësuesve (House Armed Services

Committee), dhe kanë luajtur rol të rëndësishëm në angazhimin ushtarak të ShBA-së në lidhje me NATO-n dhe më gjerë.

Pika qendrore e diskutimeve ishte fuqizimi i marrëdhënieve Kosovë - ShBA, me theks të veçantë në fushën e mbrojtjes. Kryeministri njoftoi se në katër vitet e fundit mbi 1 000 pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) kanë marrë pjesë në trajnime në programe ushtarake të ShBA-së, përfshirë edukimin ushtarak në West Point dhe U.S. Army War College. Gjithashtu, Kosova ka mirëpritur tre edicione radhazi të ushtrimeve ushtarake Defender Europe.

Në edicionin e fundit, përkatësisht në Defender Europe 2025, Komanda e Divizionit të 28 të Këmbëtorisë së Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka qenë e vendosur në aeroportin tonë ushtarak në Gjakovë, prej nga ka drejtuar të gjitha brigadat që kanë operuar në Evropën Juglindore. Sa iu përket investimeve dhe kapaciteteve mbrojtëse, kryeministri veçoi prokurimin e pajisjeve ushtarake amerikane, përfshirë edhe sistemeve anti-tank Javelin, si dhe faktin që Kosova ka nënshkruar gjithashtu Marrëveshjen për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar dhe

CISMOA, duke u bërë vendi i 33-të në botë me këtë status të besueshëm.

Krahas investimeve në mbrojtje, kryeministri u shpreh se Kosova mbetet e palëkundur në orientimin e saj euroatlantik dhe synimin për anëtarësim në NATO dhe BE, jo vetëm si përfituese nga ombrella e sigurisë, por edhe si kontribuuese në paqen dhe sigurinë në kontinentin evropian.

Gjatë takimit u diskutua edhe për mundësitë e bashkëpunimit në rrafshin ekonomik, sidomos në fushën e energjisë dhe të teknologjisë, por edhe në projekte të mëdha infrastrukturore që parashihen të realizohen si ato në transportin hekurudhor.

Kryeministri Kurti, po ashtu, theksoi përparimin ekonomik dhe demokratik të bërë në vend në vitet e fundit, siç dëshmohej edhe nga raportet e organizatave ndërkombëtare, teksa theksoi se Kosova vijon të jetë shembull se përparimi demokratik dhe rritja ekonomike mund të ecin krah për krah. Ai shprehu mirënjohjen e popullit të Kosovës dhe falënderimin e tij për kontributin historik, rolin aktiv dhe mbështetjen e vazhdueshme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ndaj shtetit të Kosovës.



OVLUÇK-ja i reagon Speciales për seancën e 28 nëntorit: Fyerje dhe shpërfillje e realitetit historik

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Organizata e Veteranëve e Luftës së UÇK-së ka reaguar për seancën e 28 nëntorit, e cila është planifikuar të mbahet në Hagë në procesin gjyqësor ndaj Hashim Thaçit, Fadil Fazliut, Isni Kilajt, Bashkim Smakajt e Hajredin Kuçit. Kjo organizatë ka theksuar se një veprim i tillë, që seanca ndaj tyre të caktohet për datën 28 nëntor, është fyerje dhe përbën shpërfillje ndaj realitetit historik të shqiptarëve. "OVLUÇK-ja, shpreh

indinjatën dhe zhgënjimin e thellë për faktin që Dhomat e Specializuara në Hagë kanë caktuar mbajtjen e një konference përgatitore ndaj ish-presidentit të vendit, z. Hashim Thaçi, pikërisht më 28 Nëntor, ditën më të shenjtë të historisë sonë kombëtare. 28 Nëntori është dita kur Gjergj Kastrioti - Skënderbeu ngriti flamurin në Krujë, duke shënuar ringritjen e shqiptarëve, është dita e Pavarësisë së Shqipërisë, ditëlindja e komandantit tonë Adem Jashari, dhe dita e

daljes publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Për ne, kjo datë nuk është vetëm një simbol kombëtar, është një identitet i tërë, i mbështetur mbi gjak, sakrificë dhe krenari. Për OVLUÇK-në, mbajtja e një seance gjyqësore në këtë datë përbën fyerje të ndjenjave tona kombëtare dhe shpërfillje të realitetit historik të popullit të Kosovës. Kjo zgjedhje e panevojshme dhe e pakuptimtë vetëm sa e thellon bindjen se Dhomat e Specializuara vazhdojnë të



tregojnë mungesë ndjeshmërie dhe një qasje të njëanshme ndaj historisë

sonë çlirimtare dhe ndaj atyre që udhëhoqën luftën për liri", ka reaguar OVLUÇK-ja.

KOSOVA... PARA VDEKJES KLINIKE!



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Kush do të besonte... askush: Dita ditës Kosova po shkërmoqet si shtet, po tkurret si vend. Shpresën për një të ardhme më të mirë e ka mbytur edhe si shprehje thjesht: ka rënë në koma shkaku i njerëzve të këqij që po e “udhëheqin”. Shkaku i antikombëtarëve që vetëm veshjen e kanë kombëtare. Shkaku i papunëtorëve që “punën” e parë të tyre e kanë bërë në mrizin e institucioneve të zaptuara dhe të kapura. Shkaku i hajnave serikë që hajninë e kanë metastazuar në çdo pore të shoqërisë, në emër të luftimit dhe diskreditimit të “regjimit të vjetër”. Shkaku i këtyre që nepotizmin dhe klientelizmin e shndërruan në oksigjen për mbajtje të pushtetit, autokrat deri në fund. E kuptoj që lideri duhet të përkrahet, mirëpo jo të glorifikohet deri në nënshtrim, të padenjë dhe të paskrupullt. Se Albin Kurthi është kryetar i LV-së nuk kundërshtohet, se ka qenë KM i Kosovës është e vërtetë e pamohueshme. Por se është “baba” i LV-së, biologjikisht nuk është e mundur, moralisht dhe tradicionalisht është shkarje mendore, skizofreni imagjinare. Se Dejana Mihali është nëna e LV-së, për trushpëlarët e saj, është gjendje normale. Për normalët është gjendje jonormale, deformim i

zinxhirit kombëtar dhe politik që nxjerrë të paditur dhe të nënshtruar serial. Si pasojë e ngjizjes antikombëtare dhe antishtetërore të “Albin babës” dhe “majka Dejonës” kemi “atdhetarë” si fatonpeca, haxhiavdyla, nezirkakovina, dimalarsovska, hekuramurata, laddymatoshka, xhelalsfeçla, besnikbislima, cendyrmusha, lenkahaxhia e shumë “atdhetarë” të tjerë. Me shumë pak përjashtime këtu bëjnë pjesë pjesa më e madhe e LV-së. Mos ta harrojmë edhe Laddy Makbeth e Zhabarit, zëdhënëse e LV-së.

E bija e grekut që vranë e kthjellë në Kosovë, Dejana Mihali: Për shumë kënd e panjohur, për mua e dyshimtë që nga dita e parë kur e kam takuar në protestat e LV-së. Si ushujzë lëvizte brenda protestuesve duke fotografuar çdo lëvizje apo moslëvizje dhe duke thithur çdo fjalë apo heshtje të protestuesve. Deri kur Albin Kurthi ra në grazhdin e Florim Kelmendit për çdo gjë konsultohet me Bacë Adem Demaçin dhe mua. Kjo spiunja atdhetare greke asnjëherë nuk ka qenë pjesë e takimeve. Ajo është marrë me indoktrinimin e anëtarësisë së LV-së gjë që e bën edhe sot. Ndaj të paditurve dhe injorantëve është sjell si Miladin Popoviqi ndaj Enver Hoxhës në Shqipëri. Kjo ka vepruar si eminenca gri e një diskursi antikombëtar në rritje brenda LV-së. Në Shqipëri nuk ta njohin as barinjët e Mallakastrës, kurse në Greqi “Nëna” Dejana dhe Albin Baba janë yjet e gjyshit Dendias, kurse Dejana është zgjatje kombëtare, politike dhe operative e babait Aleksandros, grekut me gjene dhe bindje. Kjo është atdhetarja e madhe

kombëtare që e lufton hajninë! Atdhetarinë greke dhe hajninë e Martin Strujës - diplomatit hajn, ortak i Vuk Hamoviqit që babanë e ka shef të ushtrisë serbe. Albin Baba dhe Majka Dejana, furnizimin me rrymë për Kosovën që është edhe çështje sigurie kombëtare dhe shtetërore e kanë lënë në duar të Vuk Hamoviqit dhe ushtrisë serbe.! Nëse analizoni situatën në Maqedoni të Veriut, Luginë të Preshevës atëherë i vëreni se sa të keqe kanë bërë në këto raporte tentakulat helmuese greke dhe antikombëtare të kësaj andarteje greke, zgjatje biologjike, politike dhe kombëtare e Vanizellos, Zervas dhe Metaksait që bënë gjenocid kundër shqiptarëve çamë në Greqi. Shiheni sot gjendjen në RTK, është rezultat i ndërhyrjes brutale të Laddy Mihalidis, që nga zgjedhja e drejtorit gjeneral Perëndim Gërvallës dhe mercenarëve të paepur Adi Krastës dhe Blerim Haxhija, midis të tjerëve. Pastaj gjendja në KEK, ku zonja në fjalë thërret drejtorin në takim për punësime i cili do të identifikohet me kapelë të kuqe dhe brekë rozë, sikur në rrëfimet e babait të perversitetit dhe jomoralit, Markiz de Sad. Shiheni gjendjen në diplomaci! Perversitetet dhe prostitucion diplomatik. Pastaj, bashkëpunimi me Gjykatën Speciale Raciste në Hagë kundër çlirimtarëve dhe UÇK-së. Kur të hapen letrat do të bindeni se kontribuues më të mëdhenj të kësaj Gjykate janë udbashët nga Serbia dhe udbashët nga Kosova. Të parët e bëjnë për shtetin e tyre Serbinë kurse këta të Kosovës e bëjnë për pushtet, për ta eliminuar konkurrencën politike dhe për ta marrë një

infuzion “patriotik” që as nuk e kanë pasur, as nuk e kanë, si biletë për hyrje në histori e që në shqipe i bie të hysh dhëndër me koç... të tjetrit. Dikush duhet të japë përgjigje dhe përgjegjësi si u bë që laddy Mihalidis, nga persona non grata u bë person aq i dashur për Kosovën!!! Nga një rrezikuese e sigurisë kombëtare u shndërrua në garantuese të sigurisë kombëtare. Dikush në AKI-në dhe në pronën e Xhelalit që simbolikisht quhet Ministria për Punë të Brendshme, fort i kanë për - lyer mustaqet. Duhet të japin përgjigje dhe të hetohen Vojsa Osmani, presidente në theqafje, Donika Shvarc dhe Xhelal Sfeqla, mendermethënë ministra se si u pajisë në kohë rekorde andartja greke Dejana Mihalidis me shtetësi dhe dokumente të Kosovës kundër së cilës punon 24 orë. Për ta thjeshtësuar këtë punë, AKI-ja duhet të nxirret nga kurtha e Kurthit dhe Laddy Makbeth nga Zhabari që si sekserë i përdorë Shemsi pasulin dhe Rrugacën e Parë. Po diçka është fort e sigurt; aty ku vjen era kundër Kosovës dhe shqiptarëve, mbizotërojnë pordhët e Dejonës që dalin nga kanalizimi i sigurimit grek, serb dhe maqedonas! E kjo e pafytyrë pastaj na tregon se kush paska luftuar për Kosovën dhe lirinë!

Zgjedhjet e 28 dhjetorit 2025: Po mbahen në rrethana të një depresioni të madh kombëtar për shkak të përçarjeve të mëdha. Kemi depresion ekonomik. Pasiguri për mbijetesë. Në skenë janë hijenat e moçme dhe të reja që duan, nëse jo krejt tortën, së paku një pjesë të saj. LVV-ja po hynë në hartë me shpresën e mbytur dhe

Veriun e “çliruar”. Besoj se shpresa është e mbytur pas një dhunimi 5-vjeçar kurse Veriu ishte çliruar në vitin 1999. Aktualisht Veriu më afër është ndarjes se integritetit. LDK-ja po hynë e konsoliduar në zgjedhje. AAK-ja nuk mbetet nën 7.5 për qind. PDK-ja është në gjendje, nëse nuk e menaxhon situatën, më delikate për shkak të Dadës Ra(mi)zë! PDK-ja e ka uruar Dadën Razë për fitore në Drenas dhe këtu është dashur të vë një pikë të madhe. Pse të takohet me Dadën Razë kur ajo do t'i thyejë kurrizin PDK-së e jo LVV-ja. Nga ky kënd Dada Razë është më e afërt me Kurthin përmes sekseres Lenka Haxhiu, po i pëlqen kurrizi i Kurthit prandaj nuk do ta thyejë! Dadën Razë duhet lënë në rrugëtimin e saj drejt marginalizimit politik. Me rastin e Drenasit e shpenzoi xhokerin e viktimës, për zgjedhje nacionale nuk i dhezë viktimizimi. Tash nuk është viktimë, është kryetar i Drenasit. Jam i sigurt se asnjë votues i bindur i PDK-së nuk e voton LVV-ja, prandaj ato 80.000 vota që i llogaritë Dada Razë i ngjajnë tregimin me lepurin e zënë ku fatkeq, duke bërë llogari se sa do të fitojë kur ta stërshejë. Duke luajtur me shifra milunshe, mbetet edhe pa lepur sepse i ikë veshgjati. Për një jam shumë i sigurt: ai që e voton Hashim Thaçin - kurrë nuk e voton Albin Kurthin, ai që e voton Kadri Veselin - kurrë nuk e voton Lenka Haxhiun. Nuk shkon edhe mbesa e Ahmet Haxhisë edhe e nënshtruara e andartes greke Dejana Mihalis. Ahmet Haxhiu ishte shpirti, mendja, zemra, shtylla kurrizore dhe kuptimi i shqiptarisë. Ishte vet shqiptaria. E njoh fort mirë, shumë kam punuar me te! Por duket jo edhe aq sa me drekua me mbesën e saj.

KEDS-i thekson gatishmërinë për të kontribuar në projektet hulumtuese të rrjetit distributiv

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Menaxhmenti i KEDS-it ka marrë pjesë në takimin e organizuar me aktorët e projekteve të BE-së që synojnë avancimin dhe digjitalizimin e sistemit elektroenergjetik. Në takim, ku mori pjesë edhe kryeshefi ekzekutiv i KEDS-it, Alpin Dogan, së bashku me ekipin e tij Avni Alidemaj, Turan Kocabayraktar dhe Alush Mexhuani u theksua gatishmëria e kompanisë për të kontribuar në projektet hulumtuese të rrjetit distributiv dhe për të qenë pjesë e projekteve testuese të financuara nga fondet e BE-së, në bashkëpunim me

akademinë, KOSTT-in dhe institucionet e tjera evropiane. Pjesëmarrës në takim ishin edhe Filip Rzharov nga ekipi evropian i koordinimit si dhe përfaqësuesve nga KOSTT-i dhe UBT-ja. Aty u paraqit edhe aplikacioni që mundëson monitorimin e transformatorëve, pajisjeve të mbrojtjes, kabllove, baterive dhe ndërprerësve, si dhe sistemet e parashikimit të defekteve, lokalizimit të defekteve në linjat ajrore dhe vlerësimit dinamik të kapacitetit të tyre. Këto teknologji synojnë rritjen e sigurisë, efikasitetit dhe integritetin më të madh të burimeve të ripërtërishtme të energjisë.



NGA KUFIJTË TE SIGURIA: 5 ÇËSHTJET KRYESORE PËR MARRËVESHJEN PËR UKRAINËN



Pesë pika janë, për momentin, në qendër të negociatave të nisura dje në Gjenevë. Ukraina i konsideron ato të pazëvendësueshme, ndërsa për gjithçka tjetër, rrëfen një burim evropian, “nga Kiev vijnë sinjale fleksibiliteti”. Qasja e ukrainasve mbështetet plotësisht nga qeveritë e Mbretërisë së Bashkuar, Francës, Gjermanisë, Polonisë, Finlandës dhe Italisë, si edhe nga Komisioni Evropian. Së pari, delegacioni ukrainas i udhëhequr nga Andriy Yermak u ka shpjeguar bashkëbiseduesve amerikanë se do të refuzohet çdo lloj njohjeje juridike të territoreve të pushtuara me forcë nga ushtria ruse. Siç ka përsëritur disa herë, Volodymyr Zelensky është i gatshëm të negociojë “duke nisur nga linja aktuale e frontit”. Në praktikë kjo do të thotë se askush në Kiev, as në kryeqytetet evropiane dhe, aq më pak, në Uashington, nuk mendon se një ditë Ukraina do

të rifitojë kontrollin e katër rajoneve pothuajse tërësisht të pushtuara (Donetsk, Lugansk, Kherson, Zaporizhzhia). Në draftin e planit të paraqitur nga amerikanët, përkundrazi, përcaktohet që ato territore të konsiderohen ruse “de facto”. Nuk është pra njohja juridike formale “de iure” e kërkuar nga Vladimir Putin, por megjithatë kristalizon realitetin e ri në terren: në ato toka të rrëmbyera ukrainasve do të komandojnë rusët. Ky është problemi i parë për t’u zgjidhur: ndoshta më i vështiri dhe më urgjenti, bashkë me kthimin e fëmijëve të rrëmbyer nga pushtuesit dhe shkëmbimin e të burgosurve.

Forca e reagimit të shpejtë

Hapi tjetër kyç lidhet me garancitë e sigurisë. Blloku ukrainas dhe ai evropian kanë pranuar dje se Shtetet e Bashkuara kanë bërë një hap të rëndësishëm përpara, duke u

angazhuar të aktivizojnë një mekanizëm të ngjashëm me nenin 5 të NATO-s, pra të ndërhyjnë ushtarakisht për të mbrojtur Ukrainën nëse sulmohet sërish nga rusët. Tani, megjithatë, i kërkohet amerikanëve një formulim më i fortë, duke eliminuar hapësirat e interpretimit të lëna në “planin Trump”, ku thuhet se i takon presidentit të Shteteve të Bashkuara të vlerësojë rrezikun dhe të vendosë masat. Europeanët, sidomos Franca dhe Mbretëria e Bashkuar, ushtrojnë presion për të krijuar një forcë të reagimit të shpejtë, gati për të ndërhyrë në rast të një agresioni të ri rus. Për më tepër, thonë ukrainasit, do të nevojitet monitorim konstant i lëvizjeve të ushtrisë së Putinit, për të parandaluar surpriza të reja. Diplomatat po punojnë për të ngritur një mekanizëm mbrojtjeje për Ukrainën “të ngjashëm me NATO-n”. Nëse gjendet zgjidhja, Kiev

mund të heqë dorë, në praktikë, nga hyrja në Aleancën Atlantike. Edhe për pikën e tretë mund të arrihet kompromis. Putin kërkonte çarmatosjen e Ukrainës. Drafti amerikan propozon reduktimin e ushtrisë nga 800 mijë në 600 mijë ushtarë. Nëse garancitë e sigurisë së jashtme janë të forta dhe të detyrueshme, qeveria Zelensky është e gatshme të shqyrtojë edhe një ulje të ushtrisë kombëtare. Po kështu, mund të mos jetë më e nevojshme të vendosen forca të huaja për mbrojtjen e territorit ukrainas: ato mund të mbeten jashtë kufijve, për sa kohë janë gati të veprojnë në rast nevojë.


Pika e katërt: hyrja në BE

Pika e katërt ka të bëjë me hyrjen e Ukrainës në Bashkimin Evropian. Për momentin duket si më e arritshmja. Propozimi i Trump e parashikon shprehimisht dhe, sipas të gjitha gjasave,

rusët nuk po paraqesin kundërshtime.

Pika e pestë: centrali bërthamor

Së fundi, pika e pestë: centrali i Zaporizhzhia-s. Për ukrainasit, ideja e ndarjes së energjisë së prodhuar nga impianti bërthamor me rusët nuk ka kurrfarë kuptimi. Dje, megjithatë, të dy ekipet nuk kanë hyrë në detaje të kësaj pike. Nëse zhbllkohet paketa fillestare, do të mund të diskutohet për gjithçka tjetër. Nuk do të jetë e thjeshtë, për shembull, të gjendet një marrëveshje për përdorimin e gjuhës ruse. Ndërsa mund të jetë më e lehtë arritja e një kompromisi për financat. Zelensky synon të mbledhë sa më shumë fonde për rindërtim, dhe duket më pranë një marrëveshjeje për të financuar investimet me rezervat monetare ruse të ngrira në Europë. *(Corriere della sera)*



KOSOVA IA NDIEN ERËN KUALIFIKIMIT NË KUPËN E BOTËS 2026 NJË DEKADË PAS PRANIMIT NË FIFA

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Kur Kosova e ka nisur fushatën kualifikuese për Kupën e Botës 2026 në shtator, ajo e kishte vetëm një fitore në gjithë historinë e saj të re në kualifikimet e Botërorit, dhe disfata e thellë nga Zvicra në ndeshjen hapëse për turneun e verës së ardhshme, i bëri shumë të mendojnë se ekipi kombëtar po shkonte drejt një dështimi tjetër. Por, për sa hap e mbyll sytë, Kosova i arriti tri fitore dhe dy barazime në një ndryshim drastik dhe mahnitës brenda muajsh për ta arritur playofin, dhe tani është një hap larg arritjes në Kupën e Botës, pikërisht në dhjetëvjetorin e pranimi në shtëpinë e futbollit botëror, FIFA.

Kosova nuk ka marrë pjesë asnjëherë në një turne të madh, dhe Kupa e Botës verën e ardhshme në Kanada, Meksikë dhe Shtetet e Bashkuara mund të jetë e para. Dhe, për ta arritur këtë, fillimisht ajo duhet t'i fitojë edhe dy ndeshje të tjera në playof në mars, një gjysmëfinale kundër Sllovakisë dhe një finale të mundshme kundër fituesit të përballjes Turqi - Rumani.

Për analistin dhe profesorin e sporteve në Universitetin e Prishtinës, Malsor Gjonbalaj, kualifikimi i Kosovës në Kupën e Botës "do të ishte diçka mbresëlënëse, do të ishte përfaqësimi më i mirë që do t'i bëhej vendit në arenën ndërkombëtare". "Sepse, e dini çfarë popullariteti të madh e gëzon futbollin, çfarë vëmendje të madhe ka gjithandej botës, prandaj paraqitja e Kosovës në një ngjarje si Kupa e Botës, do të ishte njohja më e mirë për shtetin e Kosovës", ka thënë për "Radion Evropë e Lirë" Gjonbalaj, po ashtu ish-futbollist.

Si arriti Kosova në playof?

Pas humbjes në ndeshjen hapëse kundër Zvicrës në Bazel në shtator, trajneri i verdhekaltërve, Franco Foda, e pranoi se ekipi i tij u paraqit dobët në mbrojtje në një formacion sulmues 4-3-3 dhe vendosi të ndryshojë qasje dhe taktikë. "Sot, megjithëse kishim shumë duele, i humbëm ato vendimetaret dhe kjo ndikoi në rezultatin final. Kundër Suedisë këtë gjë duhet ta bëjmë shumë më mirë", ka thënë ai pas humbjes.

Foda pastaj ka ndryshuar skemën dhe ka kaluar në një formacion klasik 4-4-2 në përballjen e radhës me Suedinë tri ditë më vonë në Prishtinë, duke luajtur futboll mbrojtës,



falë të cilit Kosova shënoi dy herë me kundërsulme. Taktikat e tij kryen punë dhe Kosova mori fitoren e parë në Grupin B kualifikues, 2:0.

Pas një paraqitjeje jo shumë të pëlqyer në barazimin pa gola kundër Sllovenisë në ndeshjen pasuese në shtëpi, Kosova i fitoi dy ndeshjet e radhës kundër Suedisë (1:0) dhe Sllovenisë (2:0) për ta siguruar playofin, pasi iu qëndroi besnike taktikave të Fodës. Ajo ka barazuar 1:1 me Zvicrën në ndeshjen e fundit në grup në nëntor, duke grumbulluar në fund 11 pikë në vendin e dytë, mjaftueshëm për ta kapur playofin, pasi Zvicra shkoi direkt.

Gjonbalaj ka vlerësuar se kjo vlen falë një pune të gjatë të trajnerit dhe disiplinës që ai ka sjellë në kombëtare. "Në këtë rast kemi të bëjmë me punë për një kohë bukur të gjatë, një planifikim dhe, sidomos, kemi në krye të ekipit një trajner, i cili e ka realizuar taktikën e lojës me mjaft disiplinë, i ka përzgjedhur lojtarët mjaft mirë dhe mendoj se homogeniteti i ekipit është çelësi kryesor i këtyre rezultateve deri tani", ka thënë ai.

Foda, i cili e ka marrë drejtimin e kombëtares më 2024, bëri shumë ndryshime në ekipin e parë, i ndihmuar shumë edhe

nga prurjet e reja, të cilat kanë lënë gjurmët e tyre të dukshme në ekip deri tani. Pas playofit të dështuar për Kampionatin Evropian 2020, kur u mposht nga Maqedonia e Veriut, Kosova po vuante ta rindëronte mesfushën, veçanërisht pas largimit të Hekuran Kryeziut dhe Herolind Shalës.

Pas shumë vitesh përpjekje, Federata e Futbollit ka arritur të sjellë disa mesfushorë të talentuar, si Elvis Rexhepaj më 2024 dhe Leon Avdullahu dhe Veldin Hoxha në prag të kualifikimeve këtë verë.

Rexhepaj, i cili luan për Augsburgun në Gjermani, dhe Avdullahu, i cili është pjesë e Hoffenheimit, po ashtu në Gjermani, kanë qenë vendimtarë përkrah Florent Muslijas, i cili ka pasur më shumë detyra sulmuese. Foda, madje, e vendosi mbrojtësin e djathtë të Comos në Itali, Mërgim Vojvoda, në krahun e djathtë të mesfushës, falë aftësive të tij teknike. "Tani kemi në mesfushë lojtarë që vrapojnë, bartin barrën, kanë disiplinë të jashtëzakonshme në lojë, siç janë Avdullahu, Rexhepaj, Hoxha. Ata bëjnë edhe një lojë të mirë sulmuese me Muslijas, i cili u bashkohet sulmuesve, si një lojtar shumë kreativ dhe

teknik, i cili po ndihmon të vijmë më shpejt te goli", ka nënvizuar Gjonbalaj.

Taktikat e Fodës nënkuptuan, gjithashtu, se ai që shihet si ylli më i madh dhe më i vlefshëm i kombëtares, Edon Zhegova, të mbetej jashtë ekipit të tij startues.

Zhegova, i cili iu bashkua në verë gjigantit italian Juventus, është sulmues anësor që përshatet kryesisht në një formacion sulmues 4-3-3. Lënia e Zhegrovës jashtë formacionit startues habiti shumë njerëz në Kosovë, por Fodës iu shpague kjo qasje. "Ne kemi një numër të madh të futbollistëve, secili e meriton të luajë, por secili duhet të jetë i bindur që, për ta përfaqësuar shtetin, mjaftojnë edhe 30 sekonda apo një minutë lojë. Prandaj, asnjëri nuk duhet të ndihet i fyer kur nuk luan", ka thënë Gjonbalaj.

Nuk është vetëm mesfusha që është përmirësuar gjatë kësaj kohe pas ardhjeve të reja, por edhe sulmi me Fisnik Asllanin e Hoffenheimit dhe, posaçërisht mbrojtja, ku Albion Hajdari dhe Dion Gallapeni kanë lënë mbresa.

Gallapeni, 19 vjeç, është mbase përforcimi më i dëshiruar te Kosova, që ka pasur shumë vështirësi ta gjejë një mbrojtës të

majtë solid.

Por, a është ndihmuar Kosova edhe nga faktorë të tjerë? Gjonbalaj mendon se po. Nga katër kombëtares në Grupin B, vetëm Kosova dhe Zvicra arritën fitore. Suedia e Sllovenia nuk ia dolën të merrnin më shumë se barazime. Që të dyja kanë treguar formë të dobët në këto ndeshje kualifikuese, duke pasur parasysh të kaluarën e tyre.

Suedia është paraqitur ndaj Kosovës me dy prej sulmuesve më të shtrenjtë në historinë e Premierligës angleze, Alexander Isakun e Liverpool dhe Viktor Gyokeresin e Arsenalit. Asnjëri nuk e ka bërë dallimin. "Nuk ka ekip të lehtë për t'u mposhtur, por është e vërtetë që ato nuk kanë qenë në formën e tyre më të mirë në këto ndeshje", ka thënë Gjonbalaj. Suedia, megjithatë, është në playof sikurse Kosova, jo përmes rrugës së kualifikimeve, por përmes Ligës së Kombeve, dhe në fund mund të jetë pjesë e Kupës së Botës në verë.

Gjasat e Kosovës në playof

Kosova do të donte që ndeshjet e playofit të zhvilloheshin tani, duke e parë formën e skuadrës, por asaj do t'i duhet të presë deri në fund të marsit, që nënkupton se është mbase herët të flitet për gjasat. Dardanët do të udhëtojnë në Bratislavë më 26 mars për t'u përballur me Sllovakinë në ndeshjen gjysmëfinale të playofit, të cilën duhet ta fitojnë patjetër për t'i mbajtur gjallë shpresat për një finale që do ta çonte në Botëror. "Mos të harrojmë, jemi në ekzaltim, sepse jemi në playof, por nuk e kemi kryer punën ende, duhet qetësi e madhe dhe punë e madhe profesionale, për ta arritur kualifikimin, sepse bëhet fjalë për dy ekipe shumë të forta", ka vlerësuar Gjonbalaj.

Finalen e mundshme Kosova do ta zhvillonte në Prishtinë kundër fituesit të përballjes tjetër në mes të Turqisë dhe Rumanisë më 31 mars. Derisa beson se gjasat me Sllovakinë janë shumë reale, Gjonbalaj ka thënë se përballja e mundshme me Turqinë do të ishte shumë më e vështirë. "Mendoj se me Sllovakinë kemi shumë gjasa, ndërsa në ndeshjen finale pres ta kemi kundërshtar Turqinë, e cila, mendoj, është ekip shumë i papërshtatshëm për ne, por do të kemi mundësi sepse luajmë në shtëpi", ka thënë Gjonbalaj.

Prishtina ndan rrugët me trajnerin Arsim Thaqi

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Arsim Thaqi më nuk është trajner i Prishtinës, ka bërë me dije të hënën ekipi nga Superliga e Kosovës. Në njoftimin e Prishtinës është thënë se bashkëpunimi me Thaqin është përmbyllur me marrëveshje të dyanshme. Largimi i Thaqit

erdhi dy ditë pas humbjes së Prishtinës nga Malisheva në stadiumin “Fadil Vokrri” me shifrat 2:0, ku kjo ishte ndeshja e katërt e Prishtinës pa fitore. “E falënderojmë trajnerin Thaqi për kontributin e tij të çmuar gjatë periudhës sa ishte në krye të ekipit të parë, si dhe i

dëshirojmë shumë suksese në të ardhmen. FC Prishtina dhe trajneri Thaqi mbeten të hapur për bashkëpunime të mundshme në të ardhmen”, ka njoftuar Prishtina. Thaqi ka marrë drejtimin e Prishtinës në muajin prill të vitit të shkuar dhe ka udhëhequr

ekipin drejt triumfit në Kupën e Kosovës, duke siguruar pjesëmarrjen në garat e UEFA-s. Aktualisht, Prishtina prin në tabelë këtë sezon me 26 pikë të mbledhura, tri më shumë se Ballkani, Dukagjini e Drita që renditen në pozitat dy, tre dhe katër.



PRISHTINA DHE BALLKANI MPOSHTEN NË SHTËPI

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Në fundjavë janë zhvilluar ndeshjet e xhiros së 14-t në Superligën e Kosovës në futboll. Në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin “Sami Kelmendi” në Lipjan, Drita ka shënuar fitoren e dytë rresht, duke triumfuar 2:0 ndaj Prishtinës së Re. Drita, e cila ka një ndeshje më pak të zhvilluar, aktualisht ka 23 pikë në 13 ndeshje, ndërsa Prishtina e Re mbetet në vendin e fundit me 9 pikë dhe pa fitore që nga 14 shtatori. Ndërkohë në kryeqytet, Malisheva ka arritur fitore të madhe si mysafire e Prishtinës, duke triumfuar me rezultat 2:0. Me këtë fitore, Malisheva është

ngjitur në vendin e gjashtë me 19 pikë, ndërsa Prishtina, pavarësisht humbjes, mbetet në krye të tabelës me 26 pikë, tre më shumë se ndjekësit më të afërt, Ballkani, Dukagjini dhe Drita. Kurse Llapi ka shënuar fitore të madhe në udhëtim ndaj Ballkanit, duke triumfuar me rezultat 4:2 në ndeshjen derbi të xhiros së 14-t të AlbiMall Superligës së Kosovës. Pas këtij triumfi, Llapi është ngjitur në vendin e pestë me 20 pikë. Dukagjini ka vazhduar formën e mirë, duke shënuar fitore të pastër 3:0 ndaj Drenicës në Klinë. Emocione të shumta ka pasur edhe në Gjilan, ku skuadra vendase ka barazuar 2:2 kundër

Ferizajt. Gjilani mbetet në vendin e tetë me 16 pikë, ndërsa Ferizaj është një pozitë më poshtë me 15 pikë.

JAVA E 14-t, RENDITJA E KLUBEVE	
Prishtina	26
Ballkani	23
Dukagjini	23
Drita	23
Llapi	20
Malisheva	19
Drenica	17
Gjilani	16
Ferizaj	15
Prishtina e Re	11



MUHAMET HYSENI, “YLLI I JAVËS” NË SUPERLIGË

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK), në bashkëpunim me sponsorin zyrtar të Superligës, Albi Mall, vazhdon ta japë çmimin tradicional “Ylli i Javës”, i cili i dedikohet futbollistit më të dalluar të javës në Superligën e futbollit të Kosovës. Për javën e katërmëdhjetë të këtij edicioni, ky çmim i është dhënë futbollistit të KF Llapit, Muhamet Hyseni, i cili ka pasur një paraqitje individuale shumë të mirë për skuadrën e tij për 81 minuta të ndeshjes, duke shënuar dy gola dhe duke asistuar në golin e katërt, në fitoren e rëndësishme të skuadrës së tij kundër FC Ballkanit, 2:4 në Suharekë. Vlerësimi është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit. Pasi ka marrë këtë çmim, Hyseni është shprehur i lumtur që u vlerësua si lojtari më i mirë i javës. “E kemi pasur një ndeshje të vështirë ndaj FC Ballkanit në Suharekë, megjithatë jemi të lumtur që e



kemi përgatitur ndeshjen mirë dhe kemi shënuar fitore. Klubi ynë nuk e ka nisur kampionatin në mënyrën më të mirë, por e kemi rimarrë formën dhe tashmë nuk po mungojnë as rezultatet. Personalisht, jam i lumtur që jam rikthyer në Superligë, aty ku edhe e kam

lënë, duke shënuar gola dhe duke u ndier mirë që po e ndihmoj ekipin drejt qëllimit për të qenë në pjesën e epërme të tabelës, që është edhe synimi ynë. Falënderoj bashkëlojtarët dhe stafin për ndihmën e dhënë që ta bëjmë diferencën”, ka thënë ai për faqen zyrtare të FFK-së.

MEDALJE PËR XHUDISTËT E KOSOVËS NË MAL TË ZI

PODGORICË, 24 NËNTOR - Xhudistët e rinj të Kosovës kanë vazhduar me paraqitje premtuese në gara serioze ndërkombëtare. Në fundjavë në Podgoricë është mbajtur Kupa Evropiane për juniorë, përkatësisht për xhudistët deri në 21 vjet. Laurinë Gashi në kategorinë deri 52 kilogramë dhe Enise Zijade në kategorinë deri 57 kilogramë kanë fituar medalje të argjendta, ndërsa Sidorela Dodaj është stolitur medalje bronzi në kategorinë deri 57 kilogramë. Prej xhudistëve është dalluar Furkan Kelmendi, i cili është renditur i pesti në kategorinë deri 60 kilogramë. Kosova është përfaqësuar me tetë xhudistë gjithsej në garën në Podgoricë. “Luftërat ishin të forta. Realisht Enise Zijade ishte më e mirë në çdo element në finale, por i mungoi pak durimi për të artën”, ka shkruar trajneri i Kosovës në xhudo, Driton Kuka.



Ndërkohë në Selanik është mbajtur Kupë Evropiane për kadetë. Arba Hasanaj është renditur e pesta në kategorinë deri 70 kilogramë. 15-vjeçarja fillimisht i kishte tri fitore, ndërsa më pas ka humbur në gjysmëfinale dhe në luftë për vendin e tretë.

Dy ekiye angleze vihen pas Arbër Hoxhës

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Forma e mirë e Arbër Hoxhës ka bërë që skuadrat nga Anglia të futen në garë për shërbimet e tij. Është bërë me dije se ekipet nga Championshipi, Sheffield Unitedi e Hull City

janë në garë për Hoxhën, i cili është pjesë e Dinamo Zagrebit. Hull City pati monitoruar Hoxhën edhe para fillimit të këtij sezoni, por Dinamo vendosi ta mbajë sulmuesin e krahut, i cili në


atë kohë kërkohej edhe në Turqi. Hoxha ka rinovuar kontratën me Dinamon deri në vitin 2029 dhe ka një pagë vjetore prej 500 mijë eurosh, ndërsa në janar mund të zhvendoset në Angli. 27-

vjeçari ka shënuar 5 gola dhe ka bërë 3 asistime në 17 ndeshje të luajtura në të gjitha garat për Dinamon, ekip të cilit iu bashkua në janar të vitit të shkuar nga Slaven Belupo për një milion euro.





KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLËSI



Në bazë të funksioneve dhe kompetencave që parashihen në nenin 21, lidhur me nenin 17 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike (Ligji nr.03/L-087), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-111 dhe Ligjin nr.05/L-009 për NP, Komisioni i Auditimit të KRU “Mitrovica” Sh.A., vendosi të shpall këtë:

KONKURS PUBLIK

Titulli i punës : Zyrtar/e i/e Auditimit të Brendshëm

Vendi: Mitrovicë-Suhodoll

Ndërmarrja: Kompania Rajonale Ujësjellësi,, Mitrovica,, Sh.A.

I përgjigjet: Komisionit të Auditimi të Brendshem të KRU”Mitrovica”Sh. A, Mitrovicë.

Paga bazë: 1053.99 euro

Mandati: 3 vite- me mundësi vazhdimi

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Komisioni i Auditimit dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (k) dhe (l) dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë.

Përveç këtyre kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Diplomë universitare në **ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike** ose fusha të tjera relevante për sektorin që auditohet (kopja e noterizuar ndërsa diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të **nostrifikuara** nga MASHTI);
- Certifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik**, e lëshuar nga Ministria e Financave ose ndonjë institucion relevant vendor/ndërkombëtar në pajtim me kriteret e MF;
- Certifikatë Kontabilist i Çertifikuar** nga shoqata profesionale të licencuara;
- Së paku **5 vjet përvojë pune** - në një nivel të lartë të menaxhues
- Certifikatën** për Auditor të Certifikuar (Obligative)
- Aftësi organizative, menaxhuese të njoh punën me kompjuter excel, word etj.
- Te mos ketë çfarëdo konflikti të interesit që do të shkaktoje që ky person të mos jete në gjendje të mënyrë rutinore, të mënyrë të pavarur

dhe objektivë t'i përmbushë detyrat e tij fiducare ndaj Aksionarit. Person që ka integritet të njohur.

Funksioni dhe përgjegjësitë kryesore të Zyrtares i Auditimit të Brendshëm të përcaktuara me Statutin e kompanisë:

Zyrtari i Auditimit të Brendshëm

Nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Komisionit të Auditimit, dhe duke i raportuar ekskluzivisht atij, zyrtari i auditit të brendshëm të Shoqërisë (“Zyrtari i Auditimit të Brendshëm ”) do të jetë përgjegjës për:

Udhëheqjen, menaxhimin dhe organizimin e brendshëm të zyrës së auditimit, duke zgjedhur stafin e saj;
Udhëheq dhe drejton të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm; dhe
Përmbush çfarëdo detyre tjetër të përcaktuar nga ana e Komisionit të Auditimit.

Detyrat dhe përgjegjësit e Zyrtares/ës së Auditimit të Brendshëm janë:

- Përpilimin e procedurave të auditimit, gjegjësisht planit të Auditimit të Brendshëm, për të gjitha transaksionet e Kompanisë konform objektivave të kontrollit të brendshëm, politikave dhe procedurave të Kompanisë bazuar në legjislacion të aplikueshëm,
- Shqyrtimin e planit të investimeve dhe financiar të kompanisë, planit vjetor të biznesit dhe buxhetin vjetor,
- Shqyrtimin e pasqyrës vjetore të bilancit dhe deklaratat e fitimeve dhe humbjeve si dhe deklaratat financiare që kërkohen me ligj,
- Vlerësimi objektiv të shfrytëzimit efektiv të burimeve të Kompanisë dhe dhënia e rekomandimeve adekuate për Komisionin e Auditimit dhe Menaxhmentin e Kompanisë,
- Verifikimin e përshtatshmërisë dhe funksionimit të rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të garantojnë zbatimin nga Kompania të gjitha ligjeve të aplikueshme në Kosovë gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe punëve të saj, dhe t'i sigurojë Komisionit të Auditimit çfarëdo vërejtje ose sugjerime të cilat i konsideron të nevojshme,
- Verifikimin e rregullt të përshtatshmërisë dhe funksionimit të rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim që të sigurojnë se librat dhe dokumentacioni i Kompanisë duke përfshirë dokumentacionin financiar, mbahen në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe me ligjin, dhe që projekt-deklaratat vjetore financiare të përgatiten në mënyrë të rregullt,
- Kryen analizë sistematike të proceseve të biznesit dhe kontrolleve të ndërlidhura me to,
- Raporton rregullisht para Komisionit të Auditimit,
- Udhëheq dhe menaxhon organizimin e brendshëm të zyrës së auditimit,
- Udhëheq dhe drejton të gjitha aktivitetet e Auditimit të Brendshëm,

- Mbau raporte të mira me Komisionin e Auditimit, Auditorët e jashtëm, Menaxhmentin dhe stafin e Kompanisë,
- Përmbush çfardo detyre tjetër të përcaktuar nga Komisioni i Auditimit,
- Për punën që kryen i përgjigjet Komisionit të Auditimit të Brendshëm.

Procedura e aplikimit:

Dokumentet e kërkuara

Kandidatët e interesuar duhet t'i bashkëngjisnin këto dokumente:

- Aplikacionin zyrtar të KRU “Mitrovica”.
- CV-në (jetë përshkrimin);
- Letër motivimi;
- Kopjen e diplomës universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike ose fusha të tjera relevante për sektorin që auditohet (kopja e noterizuar ndërsa diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHTI);
- Certifikatën për auditor të brendshëm në sektorin publik**, e lëshuar nga Ministria e Financave ose ndonjë institucion relevant vendor/ndërkombëtar në pajtim me kriteret e MF;
- Certifikatën** për Auditor të Certifikuar (Obligative);
- Certifikatë Kontabilist i Çertifikuar** nga shoqata profesionale të licencuara;
- Dëshmi mbi përvojën e punës (trustin apo kontratë pune ose vërtetim nga punëdhënësi që dëshmon funksionin menaxherial apo detyrat e punës dhe kohëzgjatjen e angazhimit).
- Deklarata nën betim e cila mund të shkarkohet nga uebfaqja e kompanisë;
- Certifikatën nga evidenca penale, jo më të vjetër se 6 muaj, që dëshmon se aplikanti nuk është dënuar me më shumë se 6 muaj burgim me vendim të formës së prerë.
- Kopjen e letërnjoftimit të lëshuar nga Republika e Kosovës.

Aplikacioni dhe Deklarata nën Betim mund të merren në ueb -faqen e Kompanisë në adresën: <https://www.kru-mitrovica.com/konkurset/>.

Aplikacionet dhe dokumentet përcjellëse duhet të dorëzohen të skanuara ose në formatin .pdf në email adresën: rekrutimi@kru-mitrovica.com

Afati për aplikim është 30 ditë nga dita e publikimit të Konkursit Publik duke filluar nga data: 25.11.2025 deri me datën 24.12.2025 ora 24:00.

Vërejtje: Kandidatët me dokumentacion të pakompletuar, të paplotësuar dhe jo-adekuat dhe jashtë afatit të konkurrimit, do të refuzohen.

KRU”Mitrovica”Sh.A. Mitrovicë-Suhodoll.

Prishtinë, 24.11. 2025

NJOFTIM PUBLIK

Shoqëria „Dio Bes Solar“ SH.P.K., me numër Unik Identifikues 812023852 me adresë: Rr. „Sejdi Sojeva“ p.n., Komuna e Ferizajt, Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 06.11.2025 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelët solare me kapacitet të instaluar prej 9 MW ZK Sojevë, Komuna e Ferizajt, Republika e Kosovës.

Shoqëria „Dio Bes Solar“ SH.P.K., për projektin solar me kapacitet të instaluar prej 9 MW Sojevë, Komuna e Ferizajt, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMT siç janë:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.3186-2/23 dt. 01.11.2023 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dhe Konfirmimin mbi validitetin e Pëlqimit Mjedisor nr. 9300-2/25 dt. 19.1.2.2025 të lëshuar nga MMPHI;
- Vendimin Nr. 581 të datës 03.09.2025 për dhënien e pëlqimit në parcelën kadastrale P-72217082-02054-0 ZK Sojevë, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Ferizajt;
- Vendimin për Lejimin e ndërtimit: Numri i vrojtimit: Nr. 04-351/01-0069519/25 të datës 10.09.2025, për “vendosjen e paneleve solare me kapacitet prej 9 MW, ZK Sojevë, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Ferizajt;
- Pëlqimin Elektroenergjetik Nr. 13057 dt. 03.10.2025 të lëshuar nga KEDS SH.A.;
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Dëshmi për posedimin e 10% të vlerës së investimit;
- Parakontratën për Inxhinieri, Prokurim dhe ndërtim (EPC);
- Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar,
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar deklaratën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shitet bazuar në çmimet e tregut.

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronike: v-qorrolli@hotmail.com, info@ero-ks.org ose LEGAL-LECENSING@ero-ks.org

Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për aq sa e lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.



KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD "MITROVICA" A.D.



KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD "MITROVICA" A.D.

Na osnovu funkcija i ovlašćenja predviđenih članom 21, u vezi sa članom 17 Zakona o javnim preduzećima (Zakon br. 03/L-087), izmenjen i dopunjen Zakonom br. 04/L-111 i Zakonom br. 05/L-009 o JP, Odbor za reviziju KRV „Mitrovica“ A.D. donosi odluku da objavi sledeći:

JAVNI KONKURS

Naziv radnog mesta: Službenik/ca interne revizije
Mesto: Mitrovica – Suvi Do
Preduzeće: Kompanija Regionalni Vodovod „Mitrovica“ A.D.
Odgovara: Odboru interne revizije KRV „Mitrovica“ A.D., Mitrovica
Osnovna plata: 1053,99 evra
Mandat: 3 godine – sa mogućnošću produženja

Potrebni uslovi i kvalifikacije:
Odbor za reviziju želi da obezbedi da svi potencijalni kandidati budu osobe od dokazanog integriteta koje ispunjavaju uslove kvalifikacije prema članu 17.1, da ispunjavaju kriterijume nezavisnosti prema članu 17.2, tačke (d), (f), (k) i (l), kao i da poseduju neophodno profesionalno iskustvo i obrazovanje za predmetnu poziciju.

Pored ovih opštih uslova, kandidati moraju ispuniti i sledeće posebne uslove:

- Univerzitetska diploma iz oblasti ekonomije, prava, javne administracije, javnih finansija ili drugih relevantnih oblasti za sektor koji se revidira (overena kopija, dok diplome iz inostranstva moraju biti **nostrifikovane** od strane MASHT-a);
- Sertifikat internog revizora u javnom sektoru**, izdat od Ministarstva finansija ili relevantne domaće/međunarodne institucije u skladu sa kriterijumima **MF**;
- Sertifikat ovlašćenog računovođe** od licenciranih profesionalnih udruženja;
- Minimum **5 godina radnog iskustva** – na višem nivou rukovođenja;
- Sertifikat ovlašćenog revizora** (obavezno);
- Organizacione i menadžerske sposobnosti; poznavanje rada na računaru (Excel, Word, itd.);
- Da ne postoji bilo kakav sukob interesa koji bi sprečio kandidata da redovno, savesno, nezavisno i objektivno izvršava svoje fiducijarne dužnosti prema Akcionaru; osoba sa dokazanim integritetom.

Glavne funkcije i odgovornosti Službenika interne revizije, utvrđene Statutom kompanije:

Službenik interne revizije

Pod rukovodstvom i nadzorom Odbora za reviziju, i izveštavajući isključivo tom odboru, službenik interne revizije društva („Službenik interne revizije“) biće odgovoran za:

Upravljanje, rukovođenje i interno organizovanje kancelarije interne revizije, uključujući izbor njenog osoblja;

Upravljanje i vođenje svih aktivnosti interne revizije;

Izvršavanje svih drugih dužnosti koje odredi Odbor za reviziju.

Dužnosti i odgovornosti Službenika interne revizije:

- Izrada procedura revizije, odnosno Plana interne revizije, za sve transakcije Kompanije u skladu sa ciljevima interne kontrole, politikama i procedurama Kompanije, zasnovanim na važećem zakonodavstvu;
- Analiza investicionog i finansijskog plana Kompanije, godišnjeg poslovnog plana i godišnjeg budžeta;
- Analiza godišnjeg bilansa stanja, bilansa uspeha i drugih finansijskih izveštaja koji se zahtevaju zakonom;
- Objektivna procena efikasne upotrebe resursa Kompanije i davanje adekvatnih preporuka Odboru za reviziju i Menadžmentu;
- Provera usklađenosti i pravilnog funkcionisanja sistema i procedura kojima se obezbeđuje primena svih važećih zakona u Republici Kosovo tokom obavljanja delatnosti Kompanije, kao i dostavljanje Odboru za reviziju svih zapažanja i predloga koje smatra potrebnim;
- Provera pravilnosti i urednosti sistema i procedura kojima se obezbeđuje da knjigovodstvena i finansijska dokumentacija Kompanije bude vođena u skladu sa računovodstvenim standardima i zakonom, te da se godišnji finansijski izveštaji pripremaju na pravilan način;
- Sprovođenje sistematske analize poslovnih procesa i kontrola povezanih sa njima;
- Redovno izveštavanje Odbora za reviziju;
- Rukovođenje i upravljanje internom organizacijom kancelarije interne revizije;
- Vođenje i nadzor svih aktivnosti interne revizije;

- Održavanje dobrih profesionalnih odnosa sa Odborom za reviziju, spoljnim revizorima, Menadžmentom i osobljem Kompanije;
- Izvršavanje svih drugih dužnosti koje odredi Odbor za reviziju;
- Za svoj rad odgovara Odboru interne revizije.

Procedura prijavljivanja:
Potrebna dokumentacija

Zainteresovani kandidati treba da dostave sledeća dokumenta:

- Zvaničnu prijavu KRV „Mitrovica“;
- Biografiju (CV);
- Motivaciono pismo;
- Kopija diplome univerziteta iz oblasti ekonomije, prava, javne administracije, javnih finansija ili drugih relevantnih oblasti za sektor koji se audituje (notarski overena kopija, dok diplomama sa stranih univerziteta mora biti nostrifikovana od strane MASHTI-ja).
- Sertifikat internog revizora u javnom sektoru**, izdat od Ministarstva finansija ili odgovarajuće relevantne domaće/međunarodne institucije u skladu sa kriterijumima MF;
- Sertifikat Ovlašćenog revizora** (obavezno);
- Sertifikat Ovlašćenog računovođe** izdat od licenciranih profesionalnih udruženja;
- Dokaz o radnom iskustvu (dokument iz trusta, ugovor o radu ili uverenje poslodavca kojim se potvrđuje menadžerska funkcija, odnosno radni zadaci i trajanje angažmana);
- Izjavu pod zakletvom, koja se može preuzeti sa veb-stranice kompanije;
- Uverenje iz kaznene evidencije, ne starije od 6 meseci, kojim se potvrđuje da kandidat nije osuđivan na kaznu zatvora dužu od šest meseci pravosnažnom sudskom odlukom;
- Kopiju lične karte izdane od Republike Kosovo.

Obrazac za prijavu i Izjava pod zakletvom mogu se preuzeti na veb-stranici Kompanije na adresi: <https://www.kru-mitrovica.com/konkurset/>.
Prijave i prateća dokumentacija dostavljaju se skenirane ili u .pdf formatu na imejl adresu: rekruitimi@kru-mitrovica.com
Rok za prijavu je **30** dana od dana objavljivanja Javnog konkursa, počev od datuma: **25.11.2025** do datuma **24.12.2025** do 24:00 časova.

Napomena: Kandidati sa nepotpunom, neažurnom, neadekvatnom ili neblagovremeno dostavljenom dokumentacijom biće odbijeni.

KRV „Mitrovica“ A.D. Mitrovica – Suvi Do

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “COLENCO GmbH Branch in Kosovo” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812213891dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “COLENCO GmbH Branch in Kosovo” D.O.O. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812213891ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “COLENCO GmbH Branch in Kosovo” L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 812213891the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Alban Hoti nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit “Hani Hotit” SH.P.K. me nr. Unik: 811577751.
- Shemsije Rakipi shpall te pa vlefshme dëftesën e shkollës fillore “Ilmi Bahtjari” Prizren.
- Egzon Makolli shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” Drenas.
- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.
- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, salon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



100% Fresh & Natural

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

